

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë- Ministarstvo Pravde- Ministry of Justice
Kabineti i Ministres së Drejtësisë - Ured Ministra Pravde - Office of Minister of Justice

Nr. 91 /2021
Datë: 31 /05 /2021

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (GZ, Nr. 7/01 mars 2019), duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.4) të Rregullores (QRK)-Nr. 02/2021 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, (30.03.2021), në pajtim me nenin 336 të Ligjit nr. 03/L-139 për Procedurën Përmbartimore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-118 dhe me nenin 6 të Udhëzimit Administrativ nr. 02/2013 për programin dhe mënyrën e dhënies së Provimit për Përmbartues Privat, si dhe në përputhje me nenin 53 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ministrja e Drejtësisë, nxjerrë këtë:

V E N D I M

1. Shfuqizohet Vendimi nr. 92/2020, dt. 22.10.2020, me të cilin është emëruar Komisioni dhe Sekretari për dhënien e Provimit për Përmbartues Privat.
2. Obligohet Departamenti për Profesione të Lira i Ministrisë së Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

Më datë 22.10.2020 është nxjerrë vendimi nr. 92/2020, me të cilin janë emëruar Kryetari, anëtarët, zv. anëtarët dhe Sekretari i Komisionit për dhënien e Provimit për Përmbartues Privat me mandat (2) dy vjeçar me mundësi vazhdimi.

Meqenëse prej kësaj periudhe e deri më tani, Komisioni nuk ka ndërmarrë hapa konkret për të organizuar provimin për përmbarues privat ashtu siç është përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi dhe me qëllim të ri-strukturimit të Komisionit si dhe organizimit të Provimit për Përmbarues Privat, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.


Albulena Haxhia

Ministre e Drejtësisë



Vendimi i dërgohet:

- *Ish-anëtarëve dhe ish-sekretarit të Komisionit;*
- *Kabinetit të ministres së Drejtësisë;*
- *Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm/MD;*
- *Departamentit për Profesione të Lira;*
- *Arkivit të MD-së.*



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë-Ministarstvo Pravde-Ministry of Justice
Kabineti i Ministrit të Drejtësisë-Ured Ministra Pravde-Office of the Minister of Justice

Nr. 92 /2020
Datë: 22 / 10 /2020

Në mbështetje të nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2), dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare nr. 7, 01 mars 2019), duke u bazuar në nenin 336 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Procedurën Përmbartimore, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-118, si dhe neni 6 Udhëzimi Administrativ nr.02/2013 për Programin dhe Mënyrën e Dhënies së Provimit për Përmbartues Privat, si dhe në pajtim me nenin 8 (paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4) të Rregullores nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (19.02.2020), Ministri i Drejtësisë nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Emërohet Komisioni për Dhënien e Provimit për Përmbartues Privat, (me tej Komisioni) në këtë përbërje:
 - 1.1 Adem Vokshi, Kryetar i Komisionit, pyetës për lëndën E Drejta Civile Materiale dhe procedurale, zëvendës anëtar Selim Nikqi;
 - 1.2 Ylber Shurdhiqi, anëtar i Komisionit, pyetës për lëndën Procedura Përmbartimore, zëvendës anëtar Venhar Salihu;
 - 1.3 Halide Reka, anëtar i Komisionit, pyetës për lëndën Organizimi i Gjqësorit, zëvendës anëtar Delushe Halimi;
 - 1.4 Mahir Tutuli, anëtar i Komisionit, pyetës për lëndën E Drejta Tregtare, zëvendës anëtar Franciska Zhitia;
 - 1.5 Enes Mehmeti, anëtar i Komisionit, pyetës për lëndën E Drejta Ndërkombëtare dhe të Drejta e Njeriut, zëvendës anëtar Valbona Selimaj;
2. Për sekretar të Komisionit caktohet Bahri Beqiri, Drejtor i Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme i cili i kryen punët profesionale dhe administrativo teknike për nevojat e Komisionit.

3. Obligohet Komisioni për përgatitjen dhe zbatimin e procedurave për dhënien e provimit për përmbarues privat dhe detyrat tjera të përcaktuara me Ligjin për procedurën përmbarimore dhe aktet tjera nënligjore për zbatimin e tij.
4. Mandati i kryetarit, anëtarëve të komisionit dhe sekretarit të komisionit është dy (2) vjet me mundësi vazhdimi.
5. Për punën në komisionin për provim, kryetari, anëtarët e komisionit dhe sekretari i komisionit kanë të drejtë për kompensim në shumën e caktuar nga Ministri.
6. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Selim Selimi



Ministër i Drejtësisë



Vendimi i dërgohet:

- *Anëtarëve dhe Sekretarit të Komisionit,*
- *Sekretarit të Përgjithshëm,*
- *Departamentit për Profesione të Lira,*
- *Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.*